LIGJ
Nr.9618, datë 16.10.2006

PËR RATIFIKIMIN E "MARRËVESHJES NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE SHOQËRISË "HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI" STAMBOLL, TURQI PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT"

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet "Marrëveshja ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Shoqërisë "Haci Sakir Sabun ve Gliserine Fabrikalari Turk Anonim Sirketi" Stamboll, Turqi për riskedulimin e borxhit".

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.5092, datë 2.11.2006 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë, Alfred Moisiu

MARRËVESHJE
PËR RISKEDULIMIN E BORXHIT
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
DHE "HACI SAKIR SABUN VE GLISERINE FABRIKALARI TURK ANONIM SIRKETI" STAMBOLL, TURQI

Marrëveshje e datës ……..2006 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë (Qeveria), i përfaqësuar nga Ministri i Financave dhe "Haci Şakir Sabun ve Gliserin Fabrikalari Türk Anonim Şirketi", Stamboll, Turqi, i përfaqësuar nga z. Ilyas Özsüer dhe z. Süleyman Aybars Erkan.

Neni 1

Objekt i kësaj Marrëveshjeje është riskedulimi i borxhit, për shumat e papaguara prej 711.450,00 USD, që rrjedh nga veprimet juridike tregtare të përfunduara gjatë vitit 1991 dhe që kanë mbetur të papaguara.

Përbërja e shumës së borxhit, e riskeduluar nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje riskedulimi është si më poshtë:

Kredi AG 7349/91, datë 21.1.1991, porosi nga Agroeksporti, shuma në USD 711.450,00.

Neni 2

Qeveria merr përsipër t'i paguajë "Haci Şakir Sabun ve Gliserin Fabrikalari Türk Anonim Şirketi", Stamboll, Turqi shumën prej 711 450,00 USD, në shumë të plotë, menjëherë pas hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje.

Pagesa do të bëhet për poseduesin e llogarisë së "Haci Şakir Sabun ve Gliserin Fabrikalari Türk Anonim Şirketi", në numrin e llogarisë 9099779 (llogari në USD), në Garanti Bank Kurumsal Şube Stamboll, Turqi (degë bankare e korporatës; numri i degës 381), me nr.IBAN përkatës: TR25 0006 2000 3810 0009 0997 79 USD.

Neni 3

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pas përfundimit të procedurave të nevojshme ligjore, që kërkohen nga

legjislacioni shqiptar dhe mbetet në fuqi deri sa Palët të kenë përmbushur detyrimet e tyre të parashikuara në të.

Kjo Marrëveshje nuk ndryshohet pa pëlqimin me shkrim të të dyja Palëve.

Neni 4

Njoftimet e bëra në pajtim me këtë Marrëveshje shqyrtohen si më poshtë:

Ministria e Financave
Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit
Bulevardi: "Dëshmorët e Kombit", Tiranë, Shqipëri.
Tel : ++3554228405,
Fax: ++3554228494

"Haci Şakir Sabun ve Cliserin Fabrikalari Türk Anonim Şirketi", Stamboll, Turqi
Personi i kontaktit: Süleyman Aybars Erkan
Adresa: MAYA Holding INC.
Ebulula Cd
Maya Akatlar Sitesi, M-Blok
80630, Akatlar
Istanbul – Turkey
E-mail aybars.erkan@maya.com.tr or aybars@tnn.net.tr
Tel: +90 212 351 00 22
Fax: +90 212 351 00 25 & + 90 212 351 00 31
Bërë në Tiranë, më……..2006, në tri kopje origjinale në gjuhën angleze.